



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:209682

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05729042

K.DH.SH.II.nr.923/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Ministria e Industrisë dhe Ndërmarrësisë dhe Tregtisë-Inspektorati i tregut në Prishtinë, ndaj debitorit Malësia e Hasit Shpk me NRB 811337684 me seli ne Gjilan rr. Hamdi Kurteshi, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale e Kosovës Dhomat e Shkalles se pare-Departamenti për çështje Ekonomike, KPPP.nr.584/23 i dt.27.10.2022, me datën 22.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Malësia e Hasit Shpk me NRB 811337684 me seli ne Gjilan rr. Hamdi Kurteshi, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale e Kosovës Dhomat e Shkalles se pare- Departamenti për çështje Ekonomike, KPPP.nr.584/23 i dt.27.10.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës Dhomat e Shkalles se pare- Departamenti për çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitori të paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit nr. P.nr.238/22 i dt.20.09.2022, të Përmbaruesit Privat, me te cilin ka lejuar urdhrin për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm aktvendimit te Kreditorit nr. 4270/22 i dt.07.07.2022 me te cilin debitori duhet paguaj kreditorit ne emër te gjobës shumën 1000€, me shpenzimet te procedurës.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, me te cilin kundërshtuar aktvendimin e atakuar, tutje ka deklaruar se gjykata te këtë parasysht ankesën time pa specifikuar shkaqet e ankesës.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të

Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore (LPP), gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbareim ndaj debitorit me, në bazë të dokumentit të besueshëm- vendimit nr. 4270/22 i dt.07.07.2022, sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbareimor P.nr.238/22 i dt.20.09.2022 ka lejuar përmbareimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të gjobës t'i paguaj shumën prej 1000€.

Kundër urdhrin përmbareimor debitori ka paraqitur prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin e përmbareimit.

Gjykata Komerciale e Kosovës Dhoma e Shkalles se pare- Departamenti për çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, i paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përmbareimit P.nr.238/22 i dt.20.09.2022, të Përmbareuesit Privat, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar së përmbareimi është lejuar në baze të dokumentit të besueshëm, vendimit nr. të kreditorit. Andaj marrë parasysh këto gjykata e shkallës së parë ka vendosë si në dispozitiv të aktvendimit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbareimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbareuesit privat, me të cilin është caktuar përmbareimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbareimi është lejuar në bazë të nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 të LPP-së, dokumenti përmbareues e ka cilësinë e dokumentit të besueshëm dhe të njëjtat sit e tilla paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbareimit, ashtu siç përcaktohet me dispozitivin e nenit 22 të njëjtit ligj.

Gjykata e shkalles së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës ka marrë vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj dhe sipas kësaj gjykate aktvendimi i atakuar nuk është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore.

Sipas kësaj gjykate, aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë i shqyrtuan pretendimet ankimore të debitorit, edhe sa i përket shkeljeve esenciale që ndërlihen me mungesën e përshtatshmërisë së aktit

administrativ në këtë procedurë përbarimore. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se dokumenti përbarimor rrjedh nga akti administrativ i nxjerr nga kreditori në procedurë të brendshme, i cili në aspektin formal përmban të gjitha kushtet e parapara ligjore nga Neni 27 par.1 i LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Gjykata Komerciale po ashtu vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, për arsye se me dispozitën e nenit 21 të Ligjit të Procedurës Përbarimorë përcaktohet se *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Në rastin konkret në bazë të dokumentit përbarimor Vendimin i kreditorit i përmban të gjitha elementet e përcaktuara nga neni 27 par.1 të LPP-së, pasi që në vendimin përbarimor është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit. Andaj, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit dhe kur e ka lënë në fuqi urdhrin përbarimor P.nr.238/22 i dt.20.09.2022 të lejuar nga përbaruesi privat.

Në rastin konkret edhe gjykata e shkallës së dytë vlerëson se qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, pasi që akti administrativ përmban vulën e plotfuqishmërisë dhe përbarueshmërisë, i cili vendim është nxjerr konform autorizimeve ligjore të organit të administratës. Prandaj edhe kjo gjykatë vlerëson se debitori në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij konform nenit 69 par.5 të LPP, me çka nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga neni 71 të LPP, prandaj vendosi që këto pretendime të refuzoj si të pabazuara.

Përndryshe, në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin. Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.923/24, me datë 22.05.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi